




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



KA/Nr. 2901/20
Datë: 23/11/2020

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D të datës 04.09.2020, në përbërje të Faton Merovci, Muhamet Qerimi dhe Krenare Sogojeva Dermaku, në shqyrtimin e lëndës administrative, respektivisht ankesës së Kolegjit UBT, nr.prot. 942/20H të datës 17.07.2020, kundër Vendimit të KSHC Nr. 569/20D të datës 22.06.2020 për refuzim të kërkesës së kolegjit UBT për akreditim të programeve: Mjekësi e Përgjithshme/Dr. Med; Infermieri MSc; dhe Kujdes Paliativ dhe Kirurgji/MSc, e pranuar më datë 23.10.2020, në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e datës 05.11.2020, me shumicë votash, mori:

VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Kolegjit UBT, nr.prot. 942/20H e datës 17.07.2020 dhe vërtetohet Vendimi i KSHC Nr. 569/20D i datës 22.06.2020.

ARSYETIM

Kolegji UBT më datë 24.07.2020, brenda afatit ligjor ka parashtruar Ankesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes së cilës ka kërkuar që Këshilli Shtetëror i Cilësisë të rishqyrtoj vendimin e tij të datës 22.06.2020, nr. 569/20D, me të cilin është refuzuar kërkesa për akreditim të programeve të studimit: Mjekësi e Përgjithshme/Dr. Med; Infermieri MSc; dhe Kujdes Paliativ dhe Kirurgji/MSc. Pala me Ankesën e datës 17.07.2020 pretendon se:

Këshilli Shtetëror i Cilësisë me vendimin e tij me pa të drejtë ka refuzuar aplikacionet për programet e lartcekura për akreditim duke bërë shkelje të dispozitave ligjore administrative, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

KSHC me Vendimin nr. 569/20D, të datës 22.06.2020 për programin Mjekësi e Përgjithshme, Dr.Med., bazuar në verifikimet e bëra nga AKA përmes Administratës Tatimore të Kosovës, ka konstatuar se bartësit e programit kanë marrëdhënie me orar të plotë të punës edhe në institucione tjera shëndetësore. E kjo bie ndesh me nenin 26, pika 5.3.4 të UA 15/2018.

Për programin Infermieri MSc, KSHC ka konstatuar se stafi akademik të prezantuar si bartës të këtij programi nuk i përkasin fushës së programit të studimit. Kjo bie ndesh me nenin 26, pika 5.3.4 të UA 15/2018.

Për programin Kujdes Paliativ dhe Kirurgji/MSc, KSHC ka konstatuar se stafi akademik të prezantuar si bartës të këtij programi nuk i përkasin fushës së programit të studimit. Kjo bie ndesh me nenin 26, pika 5.3.4 të UA 15/2018.

Provat e administruara:

- Vendimi KSHC-së Nr. 569/20D;
- Lista e verifikimeve nga Administrata tatimore për profesorët e paraqitur ne programin Mjekësi e përgjithshme;
- Lista e bartësve të programit Infermieri me kualifikimet e tyre (Excel);
- Lista e bartësve të programit Kujdes Paliativ dhe Kirurgji me kualifikimet e tyre (Excel);
- Raporti i KSHC-së për rishqyrtimin e ankesës nga takimi i datës 02.09.2020

Shpjegim i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi

Komisioni i Ankesave pranë AKA-së, ka pranuar ankesën nr.prot. 942/20H, datë 17.07.2020 të Kolegjit UBT me datë 23.10.2020, së bashku me dokumentacionin dhe raportin e KSHC-së nga takimi i datës 02.09.2020, me të cilën ka përshkruar pretendimin e palës dhe arsyen e refuzimit të kërkesës për akreditim.

Komisioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura ka gjetur se:

Kolegji UBT për programin Mjekësi e Përgjithshme Dr.Med, 360 ETCS ka paqitur 7 persona, si bartës të programit me orar të plotë, si në vijim: Dr. Sc. Pranvera Ibrahim, Dr. Sc. Isa Haxhiu, Dr.Sc. Zaim Gashi, Dr. Sc. Haki Jashari, Dr. Sc. Emine Disha, Dr. Sc. Nijazi Gashi, dhe Dr.Sc. Drita Kutillovci. AKA ka verifikuar nëse të njëjtit janë të paraqitur me orar të rregullt të punës. Këtë e kanë vërtetuar edhe përmes faqes zyrtare/platformës së Administratës Tatimore.

Kolegji UBT për programin Infermieri, MSc, 120 ECTS, ka paraqitur Shqipar Demaçi dhe Xhevat Kurhasani, si bartës të programit me orar të plotë. Të njëjtit, nuk i përkasin fushës së programit të studimit, e që është në kundërshtim me nenin 26, pika 5.3.4 të Udhëzimit Administrativ (MAHT) Nr. 15/2018 për akreditimin e IAL-ve.

Kolegji UBT për programin Kujdes Paliativ dhe Kirurgji/MSc, 120 ECTS Fetah Sallahu dhe Zejnë Buja, si bartës të programit me orar të plotë. Të njëjtit nuk i përkasin fushës së studimit e që është në kundërshtim me nenin 26, pika 5.3.4 të Udhëzimit Administrativ (MAHT) Nr. 15/2018 për akreditimin e IAL-ve.

Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave

Komisioni i Ankesave, pasi ka konstatuar se ankesa e Kolegjit UBT është parashtruar brenda afatit kohor, ka shqyrtuar pretendimet e palës për mos akreditimin e programeve Mjekësi e Përgjithshme Dr.Med, 360 ETCS, Infermieri, MSc, 120 ECTS dhe Kujdes Paliativ dhe Kirurgji/MSc, 120 ECTS.

Komisioni i Ankesave për programin Mjekësi e Përgjithshme Dr.Med, 360 ETCS, ka konstatuar se shtatë (7) personat e paraqitur si bartës të programit kanë marrëdhënie të rregullt pune në institucione të tjera shëndetësore. Kjo është vërtetuar përmes verifikimit në faqen zyrtare/platformën e Administratës Tatimore, ku të njëjtit figurojnë se kanë orar të rregullt të punës në institucione të ndryshme shëndetësore.

Komisioni i Ankesave për programin Infermieri, MSc, 120 ECTS dhe për programin Kujdes Paliativ dhe Kirurgji/MSc, 120 ECTS, ka gjetur se Kolegji UBT për të dyja programet ka paraqitur nga dy personat si bartës të programit me orar të plotë, e që sipas provave të administruara (Lista e profesorëve të fushës) ka konstatuar se të deklaruarit nuk i përkasin fushës së programit të studimit.

Baza ligjore e vendimit dhe arsyeja pse është e zbatueshme në rastin konkret

Bazuar në nenin 26, paragrafi 5.3.4 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, i cili përcakton se: ” *Për programet e studimit të cilat shpijen deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për një grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit.*”

Po ashtu, marrë për bazë nenin 10, paragrafin 1.2.1 të po të njëjtit Udhëzim Administrativ, i cili ka përcaktuar se KSHC aprovon listën e stafit për çdo program të studimit, i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë e që përcakton edhe bazën ligjore për vërtetimin e fushës së studimit të stafit akademik të IAL-ve.

Nga kjo, derisa është provuar se të gjithë bartësit e programit Mjekësi e Përgjithshme/Dr. Med janë me marrëdhënie të rregullt punë në institucione të tjera shëndetësore, ndërsa bartësit e programeve Infermieri MSc dhe Kujdes Paliativ dhe Kirurgji/MSc nuk janë të fushës, Komisioni i Ankesave ka vërtetuar se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore sipas nenit 26, paragrafin 5.3.4. të UA 15/2018 për akreditimin e IAL-ve të, dhe vlerëson se mbi këtë bazë ligjore ka arsyeshmëri të plotë Vendimi Nr. 569/20D i datës 22.06.2020 i KSHC-së.

Pala me datë 29.10.2020, ka qenë e ftuar nga Komisioni i Ankesave për ta ushtruar të drejtën e vet për tu dëgjuar, ashtu siç e parasheh nenin 95 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji UBT nuk e ka realizuar këtë të drejtë.


Në përfundim,

Komisioni i Ankesave pasi shqyrtimit dhe administrimit të provave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi, mbi bazën e kompetencave të dhëna me nenin 22, paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Komisioni i Ankesave në AKA


KA/Nr. 2901/20, datë 23/11/2020

Procesmbajtësi



Arianit Krasniqi

Kryetari i Komisionit të Ankesave



Faton Merovci



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve në gjykatën kompetente për konfliktet administrative.